

COMUNE DI FIRENZE
Assessorato alle Politiche del lavoro e Immigrazione
Consiglio Territoriale per l'Immigrazione - Firenze


IMMIGRAZIONE

La normativa albanese

(Guida ragionata al Testo Unico sull'immigrazione, D. Lgs. 25 luglio 1998,
n. 286 come modificato dalla Legge 30 luglio 2002, n.189)

Luigi Mughini, Anna Zucconi

Edizione aggiornata a febbraio 2003



INDEX

Asistenza Sanitare (<i>Assistenza sanitaria</i>)	p. 4
Carta di Soggiorno (<i>Carta di soggiorno</i>)	p. 7
Nenshtetesia Italiane (<i>Cittadinanza italiana</i>)	p. 9
Discrimini ier Arsye Raciale, Etnike, Kombetare e Fetare (<i>Discriminazione per motivi razziali, etnici, nazionali e religiosi</i>)	p. 11
Ekspulsioni (<i>Espulsione</i>)	p. 12
Hyrja per pune te pavarur (<i>Ingresso per lavoro autonomo</i>)	p. 13
Hyrja per pune stinore (<i>Ingresso per lavoro stagionale</i>)	p. 14
Hyrja per pune te varur (<i>Ingresso per lavoro subordinato</i>)	p. 15
Regjistrimi anagrafik (<i>Iscrizione anagrafica e obblighi dell'ospitante</i>)	p. 16
Regjistrimim ne shkollen tetevjecare (<i>Iscrizione alla scuola dell'obbligo</i>)	p. 17
Martesa (<i>Matrimonio</i>)	p. 18
Permesso di Soggiorno per Pune te Varur (Si Dipendent) (<i>Permesso di soggiorno per lavoro subordinato</i>)	p. 19
Permesso di Soggiorno per Arsye Familjare (<i>Permesso di soggiorno per motivi familiari</i>)	p. 20
Mbrojtja sociale (<i>Protezione sociale</i>)	p. 21
Reduktimi ose Perjashtimi nga Pagesa e Sherbimit te Menses Shkollore (<i>Riduzione o esonero dal pagamento del servizio di refezione scolastica</i>)	p. 22
Viza e Hyrjes dhe Permesso di Soggiorno per Studime (<i>Visto d'ingresso e permesso di soggiorno per studio</i>)	p. 23
Viza e Hyrjes dhe Permesso per Arsye Familjare (<i>Visto d'ingresso e permesso per motivi familiari</i>)	p. 26
Adresa te Dobishme (<i>Indirizzi utili</i>)	p. 29

Publicazione promossa dall'Assessorato Politiche del Lavoro e Immigrazione in collaborazione con il Consiglio Territoriale per l'Immigrazione - Firenze

Testi: Avv. Luigi Mughini, Associazione Progetto Arcobaleno Onlus
Anna Zucconi, Caritas Diocesana di Firenze

Coordinamento: U.O. Immigrazione, Direzione Sicurezza sociale, via L. Da Vinci 4a, Firenze, tel. 055 2767512/7513

e-mail: immigr@comune.firenze.it

Organizzazione editoriale: Comune Network


Traduzioni: Cooperativa srl Mondo Unico


Grafica ed impaginazione: Homographicus

Stampa: IT. COMM.

ISBN 88-86320-94-9

Tutti i testi sono sul sito www.comune.firenze.it/servizi_publici/stranieri/immigra.htm





Regjistrimi ne Servizio Sanitare Nazionale SSN (SherbiminShendetesor Kombetar) garanton asistence te plote sanitare me kushte te barabarta me shtetasit italiane.

1) Regjistrimi i detyrueshem ne Sherbimin Shendetesor Kombetar

Subjektet e interesuara:

Te huaj me permesso di soggiorno ose qe kane kerkuar rinovimin e permesso di soggiorno per nje nga motivet e meposhtme:

- pune si dependent
- pune si i pavarur
- arsye familjare
- azil politik (sipas Convencionit te Gjinevres)
- motive humanitare
- per kerkim azili politik (sipas Convencionit te Gjinevres)
- ne pritje te nje adoptimi
- ne pritje afidamenti
- per marrjen e nenshtetesisë

Asistenca sanitare i takon edhe personave te familjes ne ngarkim, me leje te rregullt qendrimi (nese nuk kane permesso di soggiorno qe u jep te drejten e asistences ne emrin e vet) dhe qe nga lindja edhe femijeve te mitur nen 18 vjec.

Vendi dhe kushtet per regjistrimin

Prane qendres territoriale (Distretto Socio Sanitari) te ASL te Komunes se rezidences ose te Komunes qe rezulton mbi permesso.

NUK ESHTË E NEVOJSHME REZIDENZA ANAGRAFIKE NE ITALI

Per te bere kerkesen jane te nevojshme:

- permesso di soggiorno (ne rast rinovimi, ricevuta e kerkimit te rinovimit)
- nese eshte i papune. certifikata e regjistrimit ne listat e punes


Kohezgjatja e regjistrimit

Regjistrimi ka kohe skadimi e cila eshte e njejte me ate te permesso di soggiorno dhe mund te shtyhet duke treguar kerkesen e rinovimit te permesso di soggiorno ose ate te rinovuar. Nuk ka asnje lloj limiti vjetor te vlefshmerise se regjistrimit.

Pasi behet regjistrimi merret Libreza Shendetesore.

Libreza Sanitare jep te drejten te marresh gratis ose me pagesen e ticket, sherbimet e meposhtme:

- zgjedhjen e mjekut te familjes dhe mjekun pediater per femijet deri ne 6 vjec.
- prej 6 deri ne 14 vjec mund te zgjidhet nje pediater ose nje mjek i pergjithshem.
- vizita mjekesore ne ambulator dhe vizita mjekesore tek specialisti
- vizita mjekesore ne shtepi
- shtrimi ne spital



- vaksinimi
- analiza gjaku, radiografi, ecografi etj.
- ilace
- asistence per rehabilitim e proteza etj.

Nese libreza sanitare vidhet ose humbet, duhet te shkohet ne qendren sanitare ku eshte leshuar kjo libereze e me nje dokument identiteti te plotesohet denoncimi. Leshimi i nje duplikato eshte i menjehershëm.

2) Regjistrimi vullnetar ne Sherbimin Sanitar Kombetar

Subjektet e interesuara

Te huaj me permesso di soggiorno per arsye te ndryshme nga ato te permendura me perpara. Keto te huaj duhet te sigurohen kunder rrezikut te semundjes, vrasjes e maternitetit ne nje nga menytrat e meposhtme:

- nepermjet kontrate sigurimi e vlefshme ne territorin kombetar me nje institut sigurimi italian apo te huaj (kontrolloni cfare tipi sigurimi eshte i parashikuar nga siguruesi)
- nepermjet regjistrimit ne S.S.N me nje pagese vjetore minimumi ne raport me te ardhurat e deklaruar. Regjistrimi esht e i vlefshem edhe per familjaret ne ngarkim pervec:
- te huaj me permesso per studime dhe qe mund te bejne nje sigurim (si me siper) ose te regjistohen vullnetarisht ne S.S.N pasi kane derdhur shumen prej 149,77 euro
- te huajt e vendosur alla pari qe mund te bejne nje kontrate sigurimi (si me siper) ose te shkruhen vullnetarisht ne S.N.N pasi te kene derdhur shumen e parashikuar 219,49 euro.

Vendi dhe kerkesat per regjistrimin:

Prane qendres territoriale (Distretto Socio Sanitari) te ASL te Komunes se rezidences ose te Komunes qe rezulton mbi permesso.

NUK ESHTË E NEVOJSHME REZIDENZA ANAGRAFIKE NE ITALI

- te derdhet shuma e parashikuar
- nje permesso e vlefshme per me shume se tre muaj (edhe me pak nese eshte student ose alla pari).

Kohezgjatja e regjistrimit


Cdo vit regjistrimi vullnetar duhet te rinovohet dhe skadon ne 31 dhjetor. Shuma duhet te derdhet e plote edhe nese regjistrimi behet gjate vitit.

Nuk lejohet regjistrimi i shtetasve te huaj me leje qendrimi per kurim ose per turizem.

3) Te huaj qe nuk kane permesso di soggiorno


Edhe te huajve qe nuk kane permesso di soggiorno u sigurohet:

- kurimet ambulatoriale e spitalore urgjente ose esenciale edhe kur ato jane te vazhdueshme, per semundje ose fatalitete. Pervec kurimeve urgjente qe nuk mund te jepen nese nuk ekziston venia e jetes ne rrezik ose e shendetit te personit,



garantohen edhe kurimet esenciale per semundjet jo te rrezikshme por qe nese nuk kurohen mund te demtojne shendetin dhe te vene jeten ne rrezik (per shembull semundje si diabeti, semundjet e zemres, te mushkerive, tensioni etj)

- Ne menyre te vecante mbrohen:
- programet e mjekesise paraprake
- shtatezania dhe materniteti
- shendeti i te miutrive
- vaksinimet
- nderhyrjet e parandalimit nderkombetar
- parandalimi, diagnoza dhe kurimi i semundjeve infektive



KARTA E QENDRIMIT CARTA DI SOGGIORNO

Keto sherbime behen pa pagese per pacientin kur ky deklaron qe nuk ka asnje lloj te ardhure.

Ne baze te ligjit italian, hyrja ne strukturat sanitare nga ana e te huajit ne rregull me lejen e qendrimit, nuk sjell asnje lloj sinjalizimi autoriteteve te sherbimit te sigurise publike, pervec rasteve qe kane te bejne me fakte kriminale.

Tesera S.T.P (I huaj perkohesisht prezent)

Qytetari i huaj i parregullt, duke shkuar ne strukturat kompetente te Qendrave Sanitare¹, mund te kerkoje dokumentin sanitar me nje kod te sigluar STP, qe ka vlere gjashtemujore, e rinovueshme ne rastin e qenies akoma ne territorin nacional, qe mund te perdoret per asistencen sanitare ambulatoriale e spitalore.

Deklarimi i lindjes se nje femije ne Itali:

Subjektet e interesuara

Deklarata e lindjes eshte e detyrueshme dhe mund te behet nga babai, nga nena ose nga nje i derguar special, nga mjeku, nga mamia ose nga persona prezente ne lindje, duke respektuar vullnetin e nenes ne rast se nuk do t'i njihet emri.

Afatet e menytrat

Deklarimi i lindjes duhet te behet:

- brenda 3 diteve nga data e lindjes prane Zyres se deklarimit te Lindjeve te Spitalit ne te cilin ka ndodhur
- brenda 10 diteve nga data ne te cilin ka ndodhur lindja prane Komunes se lindjes ose Komunes se rezidences se te porsalindurit ose te Komunes se rezidences se prinderve (ne rast se nuk eshte e njejta, pervec akordeve te bera midis tyre, kallezimi behet ne Komunen e rezidences se nenes).

1 Qendrat sanitare ku mund te terhiqen teserat STP e te merren informacione ne Komunen Firenze (per qendrat e tjera socio-sanitare, te konsultohet "Guida ai servizi" i Sherbimit te Emigracionit te Komunes Firenze):

- Via Verdi 16, tel. 055 244552
- Via di Ripoli 96, tel. 055 6580546
- Lungarno Santa Rosa 13, tel. 055 2285897 – hapur te premten ora 12.30-14.30
- Viale Mateotti 48, tel. 055 62641
- Viale Morgagni 33, tel. 0552285300



Subjektet e interesuara

Qytetaret e huaj me qendrim te rregullt ne territorin e shtetit prej te pakten 6 vjetesh, titullare te lejes se qendrimit (permesso di soggiorno) per nje arsye qe lejon nje numer te pacaktuar rinovimesh.¹

Organet e referimit

Kuestura (per modulin e kerkeses se carta di soggiorno), Qendra Sanitare Lokale ose Zyra Teknike e Komunes/Sherbimi per Shtepine (per certifikaten e pershtatshmerise se baneses), Gjykata (per certifikaten e pastertise juridike) Prokura e Republikes (per certifikaten e ceshtjeve penale ne gjykim)

Kushtet e kerkuara

Ne modulin e Kuestures duhet te tregohen:

- gjeneralitet e pergjithshme komplet
- vendin /vendet ku i huaji ka ndejtur ne Itali ne 6 vjetet e fundit
- burimet e te ardhurave duke specifikuar shumen
- vendin e rezidences

Kerkeses duhet t'i bashkangjiten:

- kopja e pasaportes ose e nje dokumenti ekuivalent, o dokument identifikimi te leshuar nga autoritetet italiane kompetente ne te cilen rezultojne nenshtetesia, data (edhe vetem viti) dhe vendi i lindjes
- kopja e deklarates se te ardhurave te vitit paraardhes ose Mod. 101 (CUD) te leshuar nga punedhenesi, ne te cilin te rezultojte nje e ardhur jo me e vogel se shumja vjetore e cekut social²
- certifikate te pastertise juridike e/ose te ceshtjeve penale ne gjykim;
- 4 fotografi per dokumenta

E per familjaret?

Carta di soggiorno mund te kerkohet edhe per bashkeshortin ose per femijet e mitur nen moshen 18 vjec bashkejetues.

Kerkeses duhet t'i shtohen:

- dokumenta qe provojne lidhjen bashkeshortore ose te femijes se mitur te leshuar nga autoritetet kompetente te Shtetit perkates, te perkthyer e te legalizuara ne ambasaden ose konsolaten italiane te atij vendi;
- dokumentacion qe provon disponibilitetin e nje banese te pershtashme qe hyn ne parametrat minimale te parashikuara nga ligji regional per banesat publike, ose ne rastin e nje femije nen 14 vjec eshte e nevojshme leja e titullarit te baneses ne te cilin i mituri do te jetoje. Ekzistenca e ketyre kerkesave duhet te atestohet nga zyra komunale³ ose Qendra sanitare lokale kompetente per territorin⁴ qe leshon nje certifikate te pershtatshmerise se kushteve higjeno-sanitare

Nese carta di soggiorno kerkohet nga nje bashkeshort i huaj, ose prind i huaj bashkejetues me shtetas italian ose shtetas te komunitetit europian rezident ne Itali, duhet te tregohen edhe gjeneralitetet e bashkeshortit italian ose te femijes se shtetasit italian bashkejetues.

Per te huajin qe eshte femije i mitur convivent, carta di sogg kerkohet nga ai qe ka

pergjegjesine per te miturin.
Per cdo familjar te shkruar mbi carta di sogg duhet te bashkangjiten 4 fotografi.

Leshimi i carta di soggiorno:

Kuestura leshon nje ricevute, duke shkruar daten ne te cilen duhet te terhiqet. Ricevuta nuk zevendeson carta di soggiorno e cila leshohet brenda 90 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses, pasi jane verifikuar kushtet e kerkuara (midis te cilave: mospatja e denimeve dhe e ceshtjeve penale ne gjykim)⁵

Dhe nese nuk leshohet ose revokohet?

I huaji mund te prezantoje ankese ne Gjykatën administrative te rrethit (TAR) brenda 60 diteve. Ekspulsioni i te huajit qe ka carta di soggiorno mund te behet vetem per arsye te renda te prishjes se rendit publik.

Vlefshmeria e carta di soggiorno:

Carta di soggiorno nuk ka skadence. Ajo njihet edhe si dokument identiteti me vlere dhjetevjetore, por mund te rinovohet cdo pese vjet mbi bazen e kerkeses se te interesuarit, me fotografi te reja.

Avantazhet e carta di soggiorno

I huaji mund:

1. te hyje ne Itali pa vize
2. te beje cdo aktivitet legal, pervec atyre qe ligji ndalon per te huajit ose qe i rezervohen vetem shtetasit italian
3. te perfitoje nga sherbimet e ofruara nga administrimi publik
4. te marre pjese ne jeten publike lokale duke patur te drejten e votes kur eshte e parashikuar nga rregullorja e enteve lokale

1 Cirkolare N.300/C/2002/1281/P12.214.9/1^ DIV i Ministrise se Brendeshme – Dep. Sigurimit Publik – precizon qe “duet te konsiderohet zoterim i nje permesso di sogg. kur ajo eshte e rinovueshme disa here dhe jo vetem brenda atyre 6 vjeteve”

2 shuma vjetore e cekut social eshte euro 4557,41

3 Komuna Firenze-Sherbimi per shtepine, Viale Guidoni 158, me hyrje per handikapatet nga Via Almerigo da Schio 1

4 Qendra sanitare – per rezidentet ne Firenze: Zyra e Higjenes dhe Shendetit Publik, Via San Salvi 12 dokumentacion qe provon te ardhurat vjetore jo me pak se shuma vjetore e cekut social nese kerkohet vetem per nje familjar, dyfish nese kerkohet peer dy ose tre familjare, trefish nese kerkohet per kater ose me shume familjare. Te ardhurat i referohen shumes se prodhuar nga te gjithet familjaret bashkejetues jo ne ngarkim.

5 ceshtjet penale i referohen gjykimeve per veprat e denuara nga art. 380 CPP e ne meyre te kufizuar veprave jo fajtores art. 381 CPP.

6 art. 80, pika 19 e ligjit 23 dhjetor 2000 n. 338, ka stabilizuar qe disa te mira ekonomike, ne te cilat eshte art. 41 D. L.vo 286/98, te bera ne favor te te huajve, i jepen shtetasve te huaj me carta di soggiorno: ceku social (per refugjatet politike nuk kerkohet carta di soggiorno), te mira e sherbime te parashikuar per invalidet civile, shurdhmecet dhe ata qe nuk shikojne civile (nese invalidi eshte i biri duhet te jete shkruar ne carta di soggiorno te prindit). Kerkesa behet ne ASL kompetente.



NENSHTETESIA ITALIANE CITTADINANZA ITALIANA

Marrja e nenshtetesisë italiane eshte percaktuar ne Ligjin n. 91 te 5 shkurtit 1992 “Norma te reja mbi nenshtetesisë”, nga DPR n. 572 te 12 tetotit 1993 “Rregullorja e ekzekutimit te ligjit 5 shkurt 1992 n. 91 rishikues i normave te reja mbi nenshtetesisë” e nga DPR n. 362 te 18 prillit 1994 mbi “Rregullore e disiplinës se procedues se marrjes se nenshtetesisë italiane”

1. Dhenia automatikisht

- a. si titull origjinal, per lindje (kriteri i grupit te gjakut)
- b. trasmetim i te drejtes; i huaji qe behet italian per natyralizimin, trasmeton automatikisht nenshtetesisë italiane femijeve te vet te mitur qe, ne momentin e arrijtes se moshes se rritur, mund te refuzojne nese jane ne zoterim te nje nenshtetesisë tjetere (femijet e rritur qe deshirojne te behen italiane, duhet te ndjekin proceduren e natyralizimit).

Kushtet

Bashkejetesa stabile dhe efektive me prindin nga data e marrjes, provuar nga certifikata e familjes ose tjetere dokumentacion te pershtatshem.

2. Per perfitim nga ligji

Kerkesa e nenshtetesisë italiane nga ana e te huajit, nuk perjashton nje gjykim nga ana e administracionit publik.

Subjektet e interesuara

- a. I huaji ose apolide (person pa nenshtetesi), kudo qe ka lindur, babai ose nena e te cilit ose te pakten njeri prej gjysherve te jene qytetare italiane te lindur ne Itali, edhe pse ne vazhdim kane humbur nenshtetesisë per refuzim. I interesuari duhet te respektojte te pakten njerin nga keto **cilesi**:
 - te beje efektivisht sherbimin ushtarak per shtetin italian e te deklarroje paraprakisht qe do te marre nenshtetesisë italiane;
 - te mbuloje nje impenjim publik ne varesi nga shteti italian, edhe jashte shtetit, e te deklarroje qe do te marre nenshtetesisë italiane;
 - te rezultojte rezident ne Itali prej te pakten 2 vjetesh nga mbushja e moshes 18 vjet e te deklarroje qe do te behet shtetas italian brenda vitit te ardhshem.
- b. I huaji i lindur ne Itali e qe ka vazhduar te jete rezident pa asnje nderprerje deri ne moshen 18 vjec.

Kushtet

Deklarate qe duhet bere prane Komunes se rezidences brenda nje viti nga mbushja e moshes 18 vjec. Zyrtari i gjendjes civile, pasi ka verifikuar cilesite, ben regjistrimin e qytetarit te ri ne regjistrin anagrafik. Ne kete rast nuk eshte e parashikuar humbja e nenshtetesisë origjinale.

3. Natyralizimi

(marrja e nenshtetesisë nepermjet leshimit te nje urdheri administrativ)


a. Per martesë

Kushtet

- te pakten 6 muaj residence legale ne Itali pas marteses ose te pakten 3 vjet nga data e marteses;
- statusi martesor ne kohen e dekretit: sipas Ministrise se Brendeshme, lidhja martesore duhet te ngelet deri ne momentin e leshimit te dekretit ministerial te



nenshtetesise. Sipas opinjonit te Keshillit te Shtetit, mjafton qe cilesite te kene egzistuar edhe pse ne momentin ne te cilin prezantohet kerkesa nuk egzistojne me.



Organet e referimit

Prefektura (ose autoritetet consolare, nese jashte shtetit)

Ministria e Brendeshme: duhet te nxjerre, brenda dy vjetesh vendimin e dhenies se nenshtetesise ose te refuzimit te saj; ne mungese te ketij vendimi pas kesaj kohe, i/e interesuari/a maturon te drejten per marrjen e nenshtetesise.

Shkaqe penguese

Egzistenca e ceshtjeve penale te renda dhe e problemeve per siguresen e Shtetit. Ne kete rast, Ministria mund t'a refuzoje kerkesen brenda dy vjetesh. Nje kerkese e re mund te prezantohet pas 5 vjetesh.

b. E rregullt

Varet nga nje vleresim i posacem nga ana e administrates dhe jepet me dekret te Presidentit te Republikes, duke marre paraprakisht opinjonin e Keshillit te Shtetit mbi propozimin e Ministrise se Brendeshme.

Kushtet

- periudha e rezidences se vazhdueshme dhe te panderprere te kerkuara (per qytetaret e huaj ne rregull me normat e hyrjes dhe ndejtjes ne Itali) per:
 - te lindurit ne Itali ose te prejardhur nga italiane: 3 vjet
 - qytetaret e huaj komunitare: 4 vjet
 - te huaj te adoptuar ne moshe jo te mitur : 5 vjet
 - apolid (te pa nenshtetesi) ose refugjate : 5 vjetqytetare jo komunitare : 10 vjet
- mungese te akteve penale
- respekt te detyrimeve fiskale
- mjaftueshmeri ekonomike: kerkesa mund te mos pranohet per arsye te «interesit publik» ne mungese te nje te ardhure qe konsiderohet e pershtateshme (euro 8779,77)

Organet e referimit

Prefektura – Zyra e nenshtetesise

Ne rast se dokumentacioni eshte i pakompletuar, Prefektura fton qe te kompletohet brenda 30 ditesh. Pasi mbaron kjo kohe, ne rast se nuk eshte kompletuar, mund t'a shtyje kerkesen me urdher te motivuar.


Ministria e Brendeshme

Procedura duhet te mbaroje brenda 2 vjetesh; pergjigja mund te vonohet dhe nuk egzistojne kohe pritjeje te parashikuara.

Nenshtetesia e dyfishte nuk u lejohet te huajve qe duan te marrin natyralizimin e rregullt: kerkohet ne rruge administrative heqja e nenshtetesise origjinale.¹

Ne modelin e kerkeses te Ministrise se Brendeshme per natyralizimin e rregullt, specifikohet qe heqja e nenshtetesise origjinale nuk duhet te demonstrohet ne momentin e prezantimit te kerkeses, por vetem mbas fteses se bere per kete nga Divizioni i Nenshtetesise te se njejtës Ministri.

¹ Heqja e nenshtetesise origjinale eshte bere nepermjet rruges administrative ne baze te art. 4 te DPR n. 362 te 18 prillit 1994, qe autorizon Ministrine e Brendeshme "te nxjerre me nje dekret te vet, dispozita persa i perket bashkangjitjes se dokumentave te metejshme".



DISKRIMINIM PER ARSYE RACIALE, ETNIKE, KOMBETARE E FETARE DISCRIMINAZIONE PER MOTIVI RAZZIALI, ETNICI, NAZIONALI E RELIGIOSI

Subjektet e interesuara

- gjithkush, qytetar i huaj apo italian, mendon se eshte diskriminuar ne ushtrimin e nje te drejte, ne perdorimin e nje sherbimi ose te nje pune ne baze te races, ngjyres, prejardhjes apo origjines kombetare ose etnike, nenshtetesise, grupit gjuhesor, bindjeve e besimeve fetare
- raprezentuesit lokal te organizatave sindakaliste me te medha ne nivel kombetar.

Kryen nje diskriminim:

- zyrtari publik ose personi i ngarkuar i sherbimit publik ose personi qe ushtron nje sherbim publik qe ne ushtrimin e detyrave te tij, kryen ose ben akte jo te parashikuara nga ligji kundrejt nje qytetari italian apo te huaj, vetem per shkak te kushteve te tij ose te berjes pjese ne nje race te caktuar, etni ose kombesi.
- gjithkush qe ne menyre te paligjshme imponon kushte me te sfavorshme ose refuzon marrjen ne pune, nje banese, nje shkollim, dhe sherbimet sociale e socio-asistenciale te te huajit tregullisht ne Itali vetem per faktin se ai eshte i huaj ose pse i perket nje race te caktuar apo nje etnie o kombesie;
- gjithkush qe pengon nepermjet veprimeve ose mos lejimeve, ushtrimin e nje aktiviteti ekonomik ligjerisht te filluar nga nje i huaj banues i rregullt ne Itali, vetem per faktin se ai eshte i huaj ose pse i perket nje race te caktuar apo nje etnie o kombesie;
- punedhenesi ose te ngarkuarit e tij te cilet bejne nje akt ose sjellje qe direkt ose indirekt, kryen diskriminim ne dem te punetoreve, vetem pse ata i perkasin nje race apo nje grupi etnik ose gjuhesor , nje feje ose nje nenshtetesie.

Organet e referimit


- Gjykata e vendit ne te cilin eshte banues i interesuari, duke prezantuar nje padi qe ekzaminohet nga gjykatesi, i cili mund te urdheroje mbarimin e nje sjelljeje diskriminuese dhe te adoptoje cdo mase tjeter per te hequr pasojat e diskriminimit. Gjykatesi mund, nese e konsideron padine te vlefshme, te denoje pergjegjesit e aktit diskriminues qe te zhdemtojne edhe ne rast se nuk behet fjale per dem material, i ashtuquajturi dem moral
- Qendra Regionale e oservacionit, informacionit e asistences ligjore¹ viktimave te diskriminimit per arsye raciale, etnike, kombetare ose fetare.

Kohet

Ne raste urgjente gjykatesi parashikon nepermjet nje dekreti te motivuar, pergjegjesi e informacione te pergjithshme. Ne kete rast fikson me te njejtin dekret, seancen e paraqitjes se paleve para tij brenda nje kohe prej 15 ditesh, duke vendosur menjehere nje skadence prej me shume se 8 ditesh per per notifikimin e padise te dekretit. Ne te tille seance, gjykatesi me nje urdher, konfermon, modifikon ose revokon masat e marra ne dekret.

¹ Ne momentin e shtrirjes se kesaj skede, nuk eshte krijuar Qendra Regionale ne fjale

EKSPULSIONI ESPULSIONE



Subjektet e interesuara

Ekspulsioni jepet nga Prefekti kur i huaji:

- ka hyre ne Itali duke iu shpetuar kontrolleve ne kufi dhe nuk eshte nxjerre jashte
- ka vazhduar te rrije ne territorin e Shtetit pa kerkuar permesso di soggiorno brenda 8 diteve pune nga momenti i hyrjes ne Itali (pervec rasteve kur vonesa varet nga shkaqe madhore), nese permesso di soggiorno eshte anuluar ose refuzuar o kur ka skaduar prej me shume se 60 ditesh dhe nuk eshte kerkuar rinovimi
- eshte konsideruar subjekt i rrezikshem, pasi eshte dhene pas trafikeve kriminale ose kur eshte i hetuar per krime ne bashkepunim me te tjere per shoqeri me karakter mafioz ose shoqeri te tjera te kesaj natyre.

Ekspulsioni eshte nje dekret i motivuar dhe menjehere i ekzekutueshem, edhe pse eshte subjekt protestimi ne gjyq dhe i komunikoher te huajit nepermjet dorezimit ne dore te urdherit te shkruar, qe permban spjegime per menytrat e kundershimit te mundshem te tij. Nese i huaji nuk kupton italishten, urdheri duhet te shoqerohet me nje permbledhje te permbajtjes, te perkthyer ne gjuhen e vet ose nese nuk eshte e mundur ne anglisht, frengjisht, spanjisht, sipas preferences se te interesuarit.

Ne rast se i huaji eshte nenshtuar ndonje ceshtjeje penale, Kuestori kerkon nulla-osta per ekspulsionin autoritetve juridike te cilat mund t'a refuzojne vetem ne rast nevojash te vecanta per ceshtjen penale. Nulla-osta konsiderohet e dhene ateher kur autoriteti juridik nuk eshte pergjigjur brenda 15 diteve nga kerkesa (pohimi ne qetesi).

Kur i huaji ndodhet akoma ne territor edhe 60 dite mbas skadimit te permesso di soggiorno ne Itali, dhe nuk ka kerkuar rinovimin, ekspulsioni permban urdherin qe te lere Italine brenda 15 diteve nga data e dorezimit te ketij urdheri. Edhe ne kete rast, Kuestori mund te kerkoje shoqerimin e menjehershem te te huajit nese Prefekti ne dekretin e ekspulsionit shpreh rrezik konkret qe i huaji mund t'i shpetoje ekzekutimit te ketij vendimi. Perndryshe ekspulsioni behet gjithmone me shoqerimin ne kufi nga ana e forcave publike.

Tutelimi

Protesta duhet te prezantohet brenda 60 diteve nga data e dorezimit te vendimit, ne Gjykatën e vendit ne te cilin ka qendren autoriteti qe ka dhene ekspulsionin.

Nese eshte marre masa e mbajtjes ne nje qender ndenjeje te perkoheshme, protesta paraqitet ne Gjykatën kompetente per konvalidimin e nje mase te tille.


Protesta mund te paraqitet personalisht edhe nepermjet ambasadave ose konsullatave italjane.

Kunder vendimit te Gjykates nuk mund te behet apel, mund te shkohet vetem ne Kasacion.

I huaji qe ka marre ekspulsion nuk mund te kthehet ne territor italian per 10 vjet pa nje autorizim special nga ana e Ministrise se Brendeshme; ne rast mos respektimi, denohet me burg nga gjashte muaj deri ne nje vit dhe perseri i jepet ekspulsion me shoqerim te menjehershem.

Prefekti, ne dekretin e ekspulsionit, duke mbajtur parasysh sjelljen e pergjitheshme te te huajit ne periudhen e ndenjes ne Itali, mund te vendose nje periudhe me te shkurter se 10 vjet, por jo me pak se 5 vjet.

Kunder dekretit te ekspulsionit, te leshuar nga Ministri i Brendeshem, per arsye rregulli publik ose siguresse te Shtetit, lejohet protesta ne TAR te Lazio, qendra ne Rome



HYRJA PER PUNE TE PAVARUR INGRESSO PER LAVORO AUTONOMO

Subjektet e interesuara

Te huajt qe duan te ushtrojne ne Itali nje aktivitet industrial, profesional, artizanal ose tregtar, apo qe duan te ndertojne nje shoqeri kapitalesh ose personash.

Menytrat

Ne limitin e kuotave te hyrjes, mund te marre vizen e hyrjes per pune te pavarur, i huaji qe prodhon ne ambasadën ose konsullatën italjane keto dokumenta:

- deklarate qe nuk ekzistojne arsye per te cilat nuk duhet te leshohet titulli i aftesisë ose autorizimit, i nevojshem per zhvillimin ne Itali te aktivitetit te pavarur te zgjedhur;
- atestat mbi parametrat financiare te referimit qe kane te bejne me disponibilitetin e burimeve financiare te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te punes se pavarur te zgjedhur, te leshuar nga Dhoma e Tregtise¹ kompetente per vendin ne te cilin aktiviteti i punes se pavarur do te zhvillohet ose dokumentacion zevendesues;
- nulla osta leshuar nga kuestura;
- dokumentacion per nje disponim te nje strehimi te pershtatshem ne Itali;
- dokumentacion mbi sasine e te ardhurave per nje shume qe duhet te jete mbi nivelin minimum te parashikuar nga ligji per perjashtimin nga shpenzimet sanitare.

Ambasada ose konsullata italjane leshon:

- vizen me te shkruajtur aktivitetin te cilit i referohet;
- nje certifikate qe ateston egzistencen e kushteve te nevojshme per dhenien e lejes se qendrimit (permesso di soggiorno) per pune te pavarur.

Kohet

Viza duhet te jete:

- leshuar ose refuzuar brenda 120 diteve nga data e prezantimit te kerkeses e dokumentacionit perkates qe ateston kushtet e parshikuara nga ligji;
- perdorur brenda 180 diteve nga data e leshimit.

Leja e qendrimit per pune te pavarur zgjat 2 vjet dhe eshte e rinovueshme.

Ushtrim i aktivitetit te punes se pavarur per te huajin qe eshte prezent ne Itali.

I huaji qe ka permesso di soggiorno qe nuk lejon aktivitet pune (per shembull turizem, kura mjekesore, kerkese azili politik etj.) mund te kerkoje ne kuesturen kompetente te vendit ne te cilin do te zhvilloje kete aktivitet pune te pavarur, shnderrimin e permesso di soggiorno ne leje per pune te pavarur. Ne kete rast pervec dokumentacionit qe eshte parashikuar per te huajin qe kerkon vizen e hyrjes per pune te pavarur, duhet te prodhohet edhe atestimi i Drejtorise Provinciale te Punes qe kerkesa e bere hyn ne kuotat e hyrjes te parashikuara per pune te pavarur te percaktuara cdo vit.

1 Dhoma e Tregtise Firenze: Piazza dei Giudici 3, tel. 055 27951

HYRJAPER PUNES STINORE INGRESSO PER LAVORO STAGIONALE



Subjektet e interesuara

Punedhenesi italian ose i huaj me dokumenta te rregullta, si dhe shoqatat e ndryshme per hesap te pjesmarresve te vet, qe duan te marrin ne pune te huaj rezident jashte shtetit per pune te stines.

Organet e referimit

Cdo province e institut, prane prefektures – Zyra Territoriale e Shtetit, nje sportel per emigracionin, pergjegjes per te gjitha proceduren e marrjes ne pune te punetoreve vartes te huaj per nje periudhe te caktuar e te pacaktuar.

Menyrat

Ne kuadrin e kuotave te hyrjes te stabilizuara nga dekretet vjetore ose nga akorde te bera ne fushen e punes stinore, punedhenesi duhet te prezantoje kerkesen me emer ne sportelin e emigracionit te provinces ku eshte rezident.

Sporteli i komunikon menjehere kerkesen qendres se punes kompetente qe verifikon brenda 5 ditesh disponibilitetin e mundshem te punetoreve italiane ose komunitare per te mbuluar ate vend pune te ofruar per stinen.

Sporteli per emigracionin, leshon autorizimin pasi ka zbatuar prioritetet e ndryshme, 10 dite pas komunikimit qe i ka bere qendres se punes dhe jo me shume se 20 dite nga data e pranimit te kerkeses se punedhenesit e trasmeton dokumentacionin se bshku me kodin fiskal ambasadave e konsullatave kur eshte e mundur nepermjet rrugeve telematike.

Zyrat e ambasadave o konsullatave te shtetit rezident ose original te te huajit, pasi bejne verifikimet e duhura leshojne vizen e hyrjes duke treguar edhe kodin fiskal.

Brenda tete diteve nga data e hyrjes, i huaji shkon tek sporteli i emigracionit qe ka leshuar nulla osta per te firmosur kontraten e soggiorno qe i mbetet atij dhe ky i fundit dergon nje kopje konsullates kompetente dhe nje tjetere zyres se punes kompetente.

Vlera minimale e permesso di soggiorno eshte 20 dite dhe ajo maksimale 9 muaj.

Punetori stinor, nese ka respektuar kushtet e shkruara mbi permesso dhe ka hyre ne Shtetin e prejardhjes sapo ka skaduar ajo, ka te drejten e prioritetit per te hyre ne Itali vitin e ardhshem per arsye pune stinore kundrejt qytetareve te tjere te atij vendi qe nuk kane hyre asnjehere me pare ne Itali per arsye pune.

Te huajit qe demonstron qe ka ardhur ne Itali te pakten dy vjet radhazi per pune stinore, mund t'i leshohet ne rast se behet fjale per pune te perseritur, nje permesso per tre vjet, me nje kohezgjatje vjetore te barabarte me ate te shfrytezuar ne vitin e fundit te dyvjecarit, me nje vendim te vetem. Viza e hyrjes ne kete rast leshohet cdo vit.

Kjo leje terhiqet menjehere nese i huaji nuk zbaton rregullat e shkruara ne tekstin unik ketu prezent.



HYRJA PER PUNE TE VARUR INGRESSO PER LAVORO SUBORDINATO



Subjektet e interesuara

Punedhenesi italian ose i huaj me dokumenta te rregullta, rezident ne Itali, qe ka nder mend te lidhe nje raport pune me nje punetor te huaj rezident jashte shtetit.

Organet e referimit

Cdo province e institut, prane prefektures – Zyra Territoriale e Shtetit, nje sportel per emigracionin, pergjegjes per te gjitha proceduren e marrjes ne pune te punetoreve vartes te huaj per nje periudhe te caktuar e te pacaktuar.

Menyrat

Ne kuadrin e kuotave te hyrjes te stabilizuara nga dekretet vjetore te leshuara nga Presidenti i Keshillit te Ministrave, punedhenesi duhet te prezantoje ne sportelin e emigracionit te provinces ku eshte rezident, ose ne ate ku ka qendren ndermarja, ose ne ate ku do te behet puna:

- kerkesen me emer per nulla osta te punes;
- dokumentacion te pershtatshem per strehimin e punetorit te huaj;
- propozimin e kontrates me kushtet e parashikuara, perfshire pagesen nga ana e punedhenesit te shpenzimeve per rikthimin e te huajit ne Atdhe;
- deklaraten ne te cilen impenjohet te komunikojte cdo ndryshim te raportit te punes.

Ne qofte se punedhenesi nuk e njej drejtpersedrejti te huajin, mund te kerkoje duke bere prezantimin e kontrates, te strehimit e te shpenzimeve per kthimin ne atdhe, nulla osta per nje ose me shume persona te shkruajtur ne **listat prane ambasadave e konsullatave**, te seleksionuara sipas kriterëve qe do te precizohen ne rreguloren e re.

Kohet

Sporteli per emigracionin komunikon kerkesat e punedhenesve qendres kompetente. Qendra merr masat per perhapjen e ofertave nepermjet rrugeve telematike duke i trasmetuar qendrave te tjera dhe duke i paraqitur mbi internet ose me cdo rruge tjeter te mundur.

Pasi kane kaluar 20 dite dhe te mos jete prezantuar asnje kerkese nga ana e punetoreve italiane ose te komunitetit europian, qendra trasmeton sportelit kerkues nje certifikate negative, ose kerkesat e bera duke komunikuar gjithashtu edhe punedhenesit.

Sporteli, pas 40 ditesh nga momenti i prezantimit te kerkeses, edhe ne rastin kur qendra per punen nuk ka dhene asnje pergjigje brenda 20 ditesh, leshon pasi ka degjuar kuestorin, nulla osta duke respektuar numrin e hyrjeve dhe cilesine e tyre te percaktuara keto nga dekreti i fluksit dhe trasmeton dokumentacionin zyrtar te konsullates kur eshte e mundur nepermjet rrugeve telematike.

Nulla osta eshte e vlefshme per 6 muaj nga data e leshimit. Brenda ketyre 6 muajve, i huaji duhet te kerkoje vizen e hyrjes ne ambasadat ne vendet e origjines dhe te hyje ne Itali.



REGJISTRIMI ANAGRAFIK¹ DHE DETYRIMET E MIKPRITESIT ISCRIZIONE ANAGRAFICA E OBBLIGHI DELL'OSPITANTE



Regjistrimi anagrafik behet

- per lindje ne zyren e komunes se rezidences se prinderve ose ne komunen ku eshte regjistruar nena ne rast se prinderit jane te regjistruar ne dy vende te ndryshme;
- per transferim te residences nga nje komune tjeter ose nga jashte shtetit deklaruar nga i interesuari, duke mbajtur parasysh dispozitat e vecanta te personave pa banese te perhershme²; dhe per faktin se nuk jane regjistruar ne gjendjen civile te asnje komune tjeter;

Te huajt e regjistruar ne anagrafe duhet te rinovojne deklaraten e vendbanimit te zakonshem ne komune, brenda 60 ditesh nga rinovimi i permesso di soggiorno.

Vendbanimi i nje te huaji konsiderohet i perhershem edhe ne rast se dokumenton qe eshte mysafir prej me shume se tre muajsh pranje nje qendre pritjeje, dhe permesso di soggiorno nese eshte e para e leshuar, duhet te jete e vlefshme per me shume se tre muaj. Rezidenca do te konsiderohet e dhene nga data e deklarimit te transferimit nga ana e te interesuarit. Regjistrimet, ndryshimet ose fshirjet anagrafike i komunikohen nga zyra, Kuestures kompetente per territorin. Ndryshimet e mundshme te vendbanimit, duhet t'i komunikohen nga i huaji kuestures kompetente per territorin brenda 15 diteve.

Fshirja nga anagrafe ndodh

- per transferim te residences ne nje komune tjeter ose jashte shtetit, dhe per transferim te vendbanimit ne nje komune tjeter per personat pa vendbanim te perhershem;
- per mosgjetje ne rast operacioni per regjistrimin e pergjithshem te popullsisme se kur mbas kontrollesh te vazhdueshme, personi rezulton i pagjetur dhe per shkak te mungeses se rinovimit te deklarates se vendbanimit te zakonshem, pasi ka kaluar nje vit nga data e skadimit te permesso di soggiorno ose te carta di soggiorno. I huaji lajmerohet dhe ftohet qe te beje kete brenda 30 diteve te ardhshme.

Karta e identitetit, pervec rasteve kur marrveshje ose akorde nderkombetare thone ndryshe, nuk eshte e vlefshme per jashte shtetit, dhe as nuk lejon qe i huaji te rrije ne Itali ne mungese te permesso di soggiorno.

Detyrime te mikpritesit e te punedhenesit

Gjithkush e me cdo titull jep strehim ose mikpret nje te huaj ose te pa nenshtetesi edhe nese i aferm apo fis, dhe e merr ne pune per cfaredo lloj arsyeje ose jep atij pronesine ose perdorimin e nje prone te paluajtshme, ne fshat o ne qytet, vendosur ne territorin e Shtetit, duhet te jape komunikacion te shkruar brenda 48 oreve, autoritetve te sigurimit publik.

Komunikacioni perfshin, pervec gjeneraliteteve te denoncuesit, edhe ato te te huajit, te dhenat e pasaportes ose te dokumentit te identifikimit, vendodhjen e sakte te prone se paluajtshme ne te cilen personi jeton, eshte mysafir ose kryen sherbim dhe titullin per te cilin behet ky komunikim.

Moszbatimi i ketyre dispozitave ligjore ndeshkohen me gjobe nga 160 euro deri ne 1100 euro.

1 Komuna Firenze, Zyra Anagrafe – Via dei Leoni 5, e hene - e shtune ora 8.30-13.00; e enjte ora 8.30-18.30

2 mundesia per te zgjedhur rezidencen prane qendrave te shoqatave vullnetare te gatshme per nje sherbim te tille, eshte pezulluar



REGJISTRIMI NE SHKOLLEN TETEVJECARE TE DETYRUESHME ISCRIZIONE ALLA SCUOLA DELL'OBBLIGO

Subjektet e interesuara

Te miturit e huaj qe ndodhen ne territorin nacional kane te drejten e shkollimit pavarisht nga rregullsia e tyre, ne format dhe menytrat e parashikuara per shtetasit italiane. Regjistrimi mund te kerkohet ne cdo periudhe te vitit.

Per te miturit e huaj aplikohen te gjitha dispozitat ligjore te vlefshme ne fushen e shkollimit, te marrjes pjese ne sherbimet edukative dhe ne jeten e komunitetit shkollor perfshire dispozitat ligjore ne sektorin e vaksinimit te detyrueshem, pervec rasteve kur perjashtohet nga ky detyrim ne baze te atestatit te leshuar nga mjeku A.S.L. Nese vaksinat kane qene bere jashte shtetit, certifikatat duhet te perkthehen e te legalizohen prane ambasades ose konsullates italijane prezente ne vendin e prejardhjes.

